



Pranuar / Dorezuar Prilimjen/Prodato Received/Delivery	18 - 01 2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHICK	195/2021		1.14



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.401/2020**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji** për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj –Demi dhe Eshref Shabani-anëtar, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.401/2020 të datës 08.12.2020 të parashtruar nga ankuesit:

dhe \_\_\_\_\_ të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat \_\_\_\_\_ me adresë “Dr. Bajram Krasniqi”, Nr. 7 në Podujevë, kundër organit të punësimit Komuna e Malishevës, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 dhe 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 18.01.2021, mori këtë:

**V E N D I M**

**I.Hedhet poshtë si e pa lejuar** ankesa me numër A.nr.401/2020 e datës 08.12.2020 e parashtruar nga ankuesit N.N,etj.

**II.Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, Shpallet jo kompetent** për vendosur për ankesën me numër A.nr.401/2020 të datës 08.12.2020 të parashtruar nga ankuesit N.N,etj.

**A r s y e t i m**

Ankuesit, N.N,etj, që të gjithë punëtorë të Komunës së Malishevës, përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokatit \_\_\_\_\_ me datë 08.12.2020 përmes postës kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 3009/2020 të regjistruar me numër A.nr.401/2020, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 50 paragrafi 1, dhe nenin 81 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil, i cili ka qenë i aplikueshëm deri me datë 09.07.2020, si dhe nenin 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka konstatuar se nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, neni 127 përcakton se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ; 2. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ.*

Andaj, duke u bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht deklarinimin e ankuesve se me datë 18.02.2020 i janë drejtuar me kërkesë Drejtorisë për Buxhet dhe Financa si dhe Zyrës së Personelit në Komunën e Malishevës, për njohjen e të drejtave të pretenduara si në ankesë, Ankesën e datës 30.06.2020 të parashtruar nga përfaqësuesi i autorizuar i ankuesve në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave pran Komunës së Malishevës, si dhe Vendimin Nr.01/918 e datës 16.09.2020 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, me të cilin është shpall jo kompetent për shqyrtimin e ankesës të ankuesve, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, vlerëson se ushtrimi i ankesës me datë 08.12.2020 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jashtë afatit ligjore të përcaktuar me nenin 127 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke u bazuar në nenin 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në piken 1 të këtij vendimi.

Ndërsa, lidhur me ankesën e ankuesit N.N,etj, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, duke i'u referuar shkresave të lëndës, respektivisht Aktvendimit të datës 05.02.2018, në bazë të provave të lëndës mbajnë pozitën e punës Roje e Sigurisë së objektit në Komunën e Malishevës, andaj te njëjtët nuk e kanë statusin e nëpunësit civil, por statusin e nëpunësit administrativo-teknik - dhe mbështetës, siç parashihet me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht neni 2 paragrafi 6 ku përcaktohet se: *Nëpunës administrativo-teknik - dhe mbështetës është zyrtari publik, që kryen veprimtari ndihmëse, të mirëmbajtjes, ruajtjes, vozitjes, si dhe veprimtari të tjera të ngjashme në institucionet e administratës publike.*

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të vendosur vetëm për nëpunësit civil dhe kandidatet për pranim në Shërbimin civil, Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në piken 2 të këtij Vendimi.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.401/2020;Datë 18/01/2021**

Sabile Aydyli  
*Sabile Aydyli*  
Procesmbajtëse



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesve Avokat z.
- Kryetarit të Komunës së Malishevës;
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Malishevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

